

# BALKANS UNITED FOR CLEAN AIR

UJEDINJEN BALKAN  
ZA ČIST ZRAK  
ОБЕДИНЕТ БАЛКАН  
ЗА ЧИСТ ВОЗДУХ



BALLKANI I BASHKUAR  
PËR AJËR TË PASTËR  
UJEDINJEN BALKAN  
ZA ČIST VAZDUH

## NË BALLKANIN PERËNDIMOR, JETOJMË BRENDA NJË REJE HELMUESE

Emetimet e ndotësve nga termocentralet e mëdha në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara, dhe termocentralet me qymyr, sipas të dhënave të fundit, emetojnë më shumë dioksid squfuri se të gjitha termocentralet e tilla në BE së bashku. Duke folur globalisht, qymyri po bëhet një gjë e së kaluarës dhe sot është më me kosto ekonomike ndërtimi i paneleve diellore dhe parqeve eolike sesa mirëmbajtja e termocentraleve ekzistuese. Kompanitë që prodhojnë dhe përdorin qymyr përballen me kosto në rritje për licencat për emetimin e dioksidit të karbonit dhe respektimin e rregulloreve mjedisore, kështu që ato po përshpejtojnë planet e tyre për të mbyllur ose të paktën kalimin në karburante të tjera.

Ndërkohë që investitorët në rajonin e gjerë po anulojnë planet e tyre për të ndërtuar termocentrale të reja, duke mbyllur ose duke njoftuar mbylljen e dhjetëra ekzistues, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina vazhdojnë t'i japin përparësi planeve të tyre për ndërtimin e termocentraleve të rinj.

**Ballkani Perëndimor ka cilësinë më të keqe të ajrit në Evropë – ndotja e ajrit shkakton më shumë se 30,000 vdekje të parakohshme në rajon çdo vit. Përdorimi i lëndëve djegëse fosile në industri, kaldaja për ngrohje, bujqësi dhe transport ka gjithashtu pasoja të mëdha shëndetësore.**

I gjithë Ballkani Perëndimor është po aq i rrezikuar, veçanërisht gjatë sezonit veror, kur shpesh mund të shohim dhe ndjejmë këtë armik të përbashkët. Është koha që të gjithë t'i bashkohemi luftës kundër ndotjes së ajrit në rajonin tonë.

Vlerësohet se 4,000 njerëz vdesin para kohe çdo vit nga ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit në Shqipëri, 5,900 në Bosnie dhe Hercegovinë, 900 në Mal të Zi, 3,400 në Maqedoninë e Veriut, 2,800 në Kosovë dhe 11,400 në Serbi. Midis 80 dhe 90 përqind e këtyre vdekjeve shkaktohen nga sëmundjet kardiovaskulare (infarkti dhe sëmundjet e zemrës). Shumica e të vdekurve, midis 50 dhe 70 përqind, vdeket e të cilëve mund t'i atribuohen cilësisë së dobët të ajrit, janë njerëz në moshë pune.

Një studim i publikuar nga HEAL, Sandbag, CAN Europe, CEE Bankwatch dhe Europe Beyond Coal tregoi se në vitin 2016, pati 3906 vdekje të parakohshme për shkak të ndotjes së ajrit nga termocentralet me qymyr në Ballkanin Perëndimor, shumica e të cilave ndodhen jashtë rajonit, në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Sipas rezultateve të hulumtimit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) në vitin 2019, vetëm në 19 qytete më të mëdha, pa përfshirë Kosovën, pothuajse 5000 njerëz vdesin para kohe nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj ajrit të ndotur çdo vit.

### **Vendet nuk ofrojnë të dhëna të përgjithshme për pasojat ekonomike të ndotjes së ajrit**

Financat publike janë nën presion, kryesisht për shkak të kostove të trajtimit dhe viteve të humbura të jetës; megjithatë, ana e shpenzimeve të buxhetit nuk e pasqyron këtë në mënyrë të konsoliduar.

Në studim thuhet se termocentralet me qymyr në Ballkanin Perëndimor janë përgjegjës për dëmet ekonomike në formën e kostove shëndetësore që arrijnë nga 6.1 deri në 11.5 miliardë euro në vit, më shumë se gjysma e të cilave përballohet nga BE-ja. Pothuajse një e treta e kostove ndodhin në Ballkanin Perëndimor dhe pasojat ndjehen edhe në Rusi dhe Egjipt. Paratë e humbura në këtë mënyrë në një ose dy vjet në rajonin tonë do të mjaftonin për të ndërtuar panele diellore që do të zëvendësonin pothuajse të gjitha termocentralet me qymyr.

Duhet të kemi parasysh gjithashtu se substancat dhe komponimet e rrezikshme të ajrit stimulojnë ndryshimet klimatike dhe se do të përballemi me një faturë të madhe edhe në këtë drejtim, në formën e përmbytjeve, thatësirave dhe epidemive.

### **Grimcat janë vrasësi më i madh nga të gjithë ndotësit e ajrit**

Termocentralet me qymyr dhe industria janë ndër burimet kryesore të emetimeve të dioksidit të squfurit në Ballkanin Perëndimor; Oksidet e azotit shkarkohen kryesisht nga termocentralet me qymyr dhe nga transporti. Në shumicën e vendeve të rajonit, emetimet e SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe grimcave nga impiantet e mëdha tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara nga planet kombëtare për reduktimin e emetimeve.

Nivelet e PM<sub>10</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> dhe NO<sub>2</sub> janë tejkualuar në Bosnjë dhe Hercegovinë. Përqendrimet e PM<sub>10</sub>, NO<sub>2</sub> dhe O<sub>3</sub> në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut shpesh tejkalojnë vlerat maksimale të lejueshme. Popullsia e Shqipërisë është shumë e ekspozuar ndaj dioksidit të azotit dhe ozonit. Nuk ka termocentrale me qymyr në këtë shtet.

Nga 37 shtete të raportuara në Agjencinë Evropiane të Mjedisit, tetë tejkualuan nivelin maksimal të rekomanduar të ekspozimit ndaj PM<sub>2.5</sub> në vitin 2018. Pesë prej tyre janë në Ballkanin Perëndimor (të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përveç Malit të Zi, për të cilin nuk kishte të dhëna). Vlera kufi ditore e PM<sub>10</sub> në qytetet e Ballkanit Perëndimor është tejkualuar nga 120 deri në 180 ditë në vit, ku kufiri i përcaktuar është 35 ditë në vit.

Qytetarët e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut vuajnë për shkak të ndotësve që shkarkohen nga termocentralet, kaldajat dhe fabrikat që përdorin qymyr dhe produkte naftë. Ajri është i helmuar nga impiantet e përpunimit të lëndëve djegëse fosile dhe kaldajat e vjetëruara të ngrohjes shtëpiake. Ndotje serioze shkaktojnë edhe aktivitetet e ndërtimit, aktivitetet e bujqësisë dhe trafiku.

Përveç faktit se shëndeti dhe mjedisi janë të rrezikuar nga zjarret në vendepozitimet e parregulluara, vitet e fundit një pjesë e popullsisë është duke përdorur gjithnjë e më shumë plastikën, gomën dhe drutë e hedhura të llakuara e të lyera, si lëndë djegëse për sobat shtëpiake. Kjo nuk është domosdoshmërisht rezultat i injorancës, por një reflektim i varfërisë, në këtë rast varfërisë energjetike.

Për më tepër, ne po gjenerojmë një sasi në rritje të mbetjeve dhe sistemi nuk ka përgjigje adekuatë për këtë, apo për çështje të tjera që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit.

## Presion dhe veprim i përbashkët drejt ajrit të pastër

Institucionet janë përgjegjëse para qytetarëve. Fushata Ballkani i Bashkuar për Ajrin e Pastër është pjesë e përpjekjes solidare dhe të përbashkët të banorëve të çdo rruge, lagjeje, fshati dhe qyteti në Ballkanin Perëndimor për të qenë në gjendje të thithin ajër të pastër. Në nivel global, qymyri po bëhet një kujtim i keq. Është tashmë më kosto-efektive të ndërtohen panele diellore dhe parqe eolike sesa të mirëmbahen shumica e termocentraleve ekzistuese, madje edhe më të reja. Pajisjet për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme po bëhen në mënyrë drastike më të lira. Kompanitë që prodhojnë dhe përdorin qymyrin përballen me kosto në rritje për sa i përket lejeve të emetimeve të karbonit dhe pajtueshmërisë me rregulloret mjedisore. Prandaj, ata po përshpejtojnë planet e tyre për të mbyllur ose të paktën për të kaluar në karburante të tjera.

### **Gjashtëmbëdhjetë termocentrale me qymyr në Ballkanin Perëndimor emetuan më shumë dioksid sqfuri në vitin 2016 sesa të gjitha së bashku (250 termocentrale) në BE**

Sipas të dhënave nga raporti i lartpërmendur i publikuar në 2016 nga HEAL dhe organizata të tjera, gjashtëmbëdhjetë termocentrale me qymyr në Ballkanin Perëndimor (ende numri i tyre deri më sot), emetuan më shumë dioksid sqfuri (SO<sub>2</sub>) se të gjithë (250 termocentrale) që operojnë në Bashkimin Evropian së bashku. Sipas të dhënave të mbledhura nga Europe Beyond Coal, ndërkohë kanë mbetur vetëm 219 termocentrale aktive me qymyr mbi kapacitetin prej 15 megavat në BE dhe Mbretërinë e Bashkuar. Në rajonin më të gjerë, që përfshin Turqinë, investitorët vetëm vitin e kaluar anuluan planet për të ndërtuar nëntë, duke mbyllur ose duke njoftuar mbylljen e 68 termocentraleve të tjerë.

Është thujse e sigurt që disa projekte të mbetura do të ndërpriten dhe pyetja është se çfarë do të ndodhë me ato tashmë në ndërtim. Pothuajse gjysma e anëtarëve të BE-së synojnë të heqin plotësisht qymyrin brenda dhjetë viteve të ardhshme dhe ky numër mund të rritet lehtësisht. Tendencia të ngjashme ka në Japoni, Kinë dhe Shtetet e Bashkuara. Ndërkohë, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina vazhdojnë të shtyjnë planet e tyre për ndërtimin e termocentraleve të reja.

### **Paratë publike nuk duhet të shpenzohen për financimin e industrisë së pisët të qymyrit**

Në një mënyrë ose në një tjetër, vendet në rajon shpenzojnë shuma të mëdha parash të taksapaguesve për minierat e qymyrit dhe ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rindërtimin e termocentraleve. Duke qenë se ky sektor po humbet betejën e tregut me burimet e rinovueshme të energjisë, nuk mund të mbijetojë pa subvencione dhe ato fonde sigurisht që mund të përdoren më mirë.

Sistemi i stacioneve matëse të ndotjes ende shpesh nuk i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme. Edhe këtu ka vend për angazhim të qytetarëve. Një numër i madh i pajisjeve të vogla matëse të cilësisë së ajrit në familje janë të lidhura në rrjet përmes aplikacioneve të njohura celulare dhe bëhen një mjet që mund të kontrollojë të dhënat e qeverisë për ndotjen e ajrit, e cila nganjëherë nuk është e besueshme.

Në Maqedoninë e Veriut, tashmë ka stimuj për të zëvendësuar kaldaja për ngrohje me lëndë djegëse fosile në familje me zgjidhje më të pastra, të cilat vendet e tjera në rajon mund të imitojnë. Gjetkë në Ballkanin Perëndimor, ka pasur zhvillime modeste, veçanërisht në lidhje me termocentralet që përdorin burime të rinovueshme të energjisë. Uzinat e biomasës po shfaqen në Serbi dhe Bosnjë e

Hercegovinë dhe pompat gjeotermale po përdoren gjithnjë e më shumë në rajon për ngrohjen dhe ftohjen e objekteve.

## Ballkani mund të zbatojë tranzicionin energjetik vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta

### Hegja graduale e qymyrit është hapi më i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së ajrit

Vendet në rajon duhet të jenë të vetëdijshme për faktin se nuk ka të ardhme me termocentrale të vjetruara dhe se e vetmja zgjedhje është një kalim i përsheptuar drejt energjisë diellore dhe të erës. Funksionimi i një sistemi të tillë, i cili varet nga kushtet atmosferike, kërkon ndërlidhjen e rrjeteve elektrike të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndërtimin e objekteve të ruajtjes së energjisë elektrike. Këto janë masat më të rëndësishme për uljen e ndotjes së ajrit. Megjithatë, progresi serioz kërkon gjithashtu standarde më të forta të cilësisë së ajrit dhe rregullore të përmirësuara për ndotësit, si dhe zbatimin e tyre rigoroz në rastin e termocentraleve shtetërore, por edhe ato në pronësi private.

Të gjashtë vendet e rajonit tonë nënshkruan Deklaratën e Sofjes në nëntor 2020, duke pranuar kështu Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe duke u zotuar të ndjekin politikën e BE-së dhe planin e saj të gjelbër evropian që parashikon arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Bashkëpunimi rajonal është një rrugë drejt përmirësimit cilësinë e ajrit, por gjithashtu mund të çojë në progres teknologjik dhe përmirësim të konkurrencës ekonomike, me mundësinë e ngritjes dhe tejkalimit të ambicioneve dhe qëllimeve të përcaktuara në dokument.

Axhenda e Gjelbër për rajonin nënkupton rregullimin e ndikimit ndërkufitar të ndotjes së ajrit, miratimin e strategjive për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ngritjen e kapaciteteve të sistemeve të matjes. Liderët e BE-së kanë treguar se qasja në grante dhe kredi të lira nuk do të jetë e mundur nëse qëllimet nuk përmbushen.

Qytetarëve duhet t'u lehtësohet instalimi i pajisjeve për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme në familjet e tyre. Për më tepër, projektet e efikasë së energjisë në fushën e projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave, si dhe stimujt dhe subvencionet, mund të reduktojnë ndjeshëm konsumin e karburantit.

